



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1321 / Prot.

Vlorë, më 07.07.2023

VENDIM

Nr 35, datë 06.07.2023  
PËR

NJË NDRYSHIM NË FORMATIN E DIPLOMËS SË STUDIMEVE PROFESIONALE  
LËSHUAR NGA UNIVERSITETI " ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimi nr.10, datë 30.03.2020, "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga IAL/të dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin e diplomave ose certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", ndryshuar me Udhëzimin e MAS nr.5, datë 03.03.2021 dhe Udhëzimin e MAS me nr.14 datë 21.06.2022, Vendimit nr. 39 të Senatit Akademik, datë 26.10.2022 "Për miratimin e formatit të diplomës për programet e reja të miratuara për vitin akademik 2021-2022" pika2, ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr.51 datë 14.11.2022, si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1219, prot, datë 21.06.2023, Senati Akademik në mbledhjen e dates 06.07.2023,

VENDOSI:

- Të miratojë propozimin për ndryshimet në formatin e diplomës së studimeve profesionale, që lëshohet nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë si më poshtë:
  - Në pikën 10.
    - Zëvendësohet**- "Kohëzgjatja normale e studimeve" me "Kohëzgjatja normale e programit të studimit"
    - Hiqet**- "Numri i regjistrimit të veçantë"
    - Hiqet**- "Numri i regjistrimit të njohjes/njësimit të diplomës".
    - Zëvendësohet**- "ID e Maturës Shtetërore" me "ID e Maturës Shtetërore/Nr. i njëvlefshmërisë së diplomës (Nr. i regjistrimit)"
    - Zëvendësohet**- "Forma e studimit" me "Forma e studimeve"
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Kryesore, Zëvendësrektorit Akademik, Drejtoria e Edukimit për Ciklin e I dhe të II të studimeve.
- Bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi formati i diplomës për studimet profesionale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. ROLAND ZISI

